

Për:	Operatori Ekonomik: “Gashi Ing” Sh.p.k. me adresë në Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	23.09.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **22.09.2021**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: “Gashi Ing” Sh.p.k. me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - FAZA E DYTË**, me Numër të prokurimit: **623-21-4731-5-1-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-044-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: “Gashi Ing” Sh.p.k. me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - FAZA E DYTË**, me Numër të prokurimit: **623-21-4731-5-1-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-044-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **16.08.2021**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave, pika II. *Kurdo qe miratimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues do te beje publikimin e Njoftimit për korrigjim te gabimeve, duke përdorur formularin B54.*
- III. **Vërejtje:** Komuna do të bëjë korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara sipas Ligjit të Prokurimit Publik për Pretendimet ankimore qe janë pjesërisht të bazuar.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: "Gashi Ing" Sh.p.k. me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË KOMUNËN E RAHOVECIT - FAZA E DYTË**, me Numër të prokurimit: 623-21-4731-5-1-1, Nr. i brendshëm: 623-21-044-5-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: 16.08.2021, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 22.09.2021, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR:

Në dosjen e tenderit në piken 2.3 kanë kërkuar Inxhinier i diplomuar apo master me infrastrukturë rrugore, ku si kriter është diskriminues, dhe ulet konkurenca. A ka mundësi që ky kriter të ulet në Bachelor të Infrastruktura rrugore. Më heret nuk është kërkuar në komunën tuaj ky kriter të natyrës së kontratës.



PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është pjesërisht i bazuar,

Lidhur me Kërkesën tuaj për Inxhinier të Diplomuar apo master-Drejtimi Infrastrukturë rrugore, ky kriter nuk është diskriminues, pasi që me një kërkim të thjeshtë në ueb-faqen e Universitetit të Prishtinës thuhet se ky drejtim ka filluar në vitin Akademik 2012

Kurse Kërkesa 2.3. Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master - Drejtimi Infrastruktura Rrugore - me përvojë pune në projektim min. 3 vite pas diplomimit

Ndërsa lidhur me pretendimin ku cekë: Më heret nuk është kërkuar në Komunën tuaj ky kriter të natyrës së Kontratës, është i pabazuar dhe për këtë ju argumentojmë me tituj të projekteve ku është përdorur ky kriter:

- ✦ **NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI DERI NË XËRXË;**
Data e dorëzimit të Njoftimit të Kontratës në KRPP: 20.08.2019;
- ✦ **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME – Ritenderim,** Data e dorëzimit të Njoftimit të Kontratës në KRPP: 04.05.2020;
- ✦ **NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NË KOMUNËN E RAHOVECIT,** Data e dorëzimit të Njoftimit të Kontratës në KRPP: 22.07.2020; (Ky tenderi ka qenë i ndarë me Loto, ku fitues i Lot II jeni ju, po në bazë të kritereve të njëjta të cilat pretendoni se nuk i kemi pasur)

Me B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara,

Tek Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 2.3. Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master - Drejtimi Infrastruktura Rrugore - me përvojë pune në projektim min. 3 vite pas diplomimit

Do të ndryshohet ne:

Kërkesa 2.3. Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master - Drejtimi Infrastruktura Rrugore - me përvojë pune në projektim min. 3 vite pas diplomimit, ose Bachelor i Diplomuar me Tre (3) vite përvojë pune pas diplomimit.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit